

# BULETIN

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP)

UN HABITAT  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

funded by:  
Sida

## MuSPP-I SJELLË PËRVOJAT ME LIGJERATË DHE ME KONFERENCË PËR PLANIFIKIMIN PJSËMARRËS

“Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës” ishte tema e konferencës së organizuar nga Programi i Planifikimit Hapësinor Komunal i UN-HABITAT-it, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të partnerëve tjerë të involvuar në proceset e vizionimit në komunat e MuSPP-it, si fondacioni Friedrich Ebert (FES) dhe Trashëgimia Kulturore pa Kufi (CHWB). Gjatë katër viteve të fundit, u organizuan nëntë punëtori të vizionimit si aktivitete të planifikimit pjesëmarrës me pjesëmarrje aktive të zyrtarëve qeveritarë dhe të organizatave të shoqërisë civile, Kjo konferencë i mbledhi rreth 150 profesionistë të planifikimit nga mbarë Kosova, të cilët i sollën eksperiencat e tyre dhe diskutuan për planifikimin pjesëmarrës dhe strategjik në Kosovë, si dhe jashtë saj. Pjesëmarrësit e patën rastin të mësojnë nga prezentimet e tre ekspertëve planifikimit nga Suedia, Turqia dhe Shqipëria.

I përbërë nga katër sesione, konferenca ishte një mundësi e mirë e shkëmbimit të eksperiencave ndërmjet ekspertëve të planifikimit në Kosovë.

Konferenca filloi me fjalët hyrëse të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i cili theksoi se “rezultatet e ngritjes së kapaciteteve si në nivelin lokal dhe në atë qendror në mbështetje të UN-HABITAT-it kanë filluar të jenë të dukshme, ku e kemi draftin e PZHK-së së Junikut hartuar nga kapacitetet e brendshme komunale, ku me metodë të njejtë janë duke u hartuar edhe planet e Hanit të Elezit dhe Mamushës”. Udhëheqësja e zyrës së UN-HABITAT-it në Kosovë, znj. Krystyna Galezia, në fjalën e saj hyrëse e theksoi rolin e UN-HABITAT-it dhe bashkëpunimin me komunat për promovimin e qasjes në planifikimin pjesëmarrës dhe metodat strategjike të planifikimit.

Prezantimi i parë i konferencës u bë nga zyrtarët e MuSPP-it respektivisht nga Znj. Arijeta Himaduna dhe Z. Ishaku Maitumbi të cilët e përshkruan tërë procesin e vizionimit si dhe prapavijën e projektit i cili çoi deri te organizimi i konferencës.

Konferenca u nderua me prezencën e Z. Steve Johnson, Udhëheqës i Departamentit për Planifikim dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komuniteteve nga Komuna e Borlanges në Suedi; Z. Flamur Kuçi, këshilltar i krye-ministrit të Shqipërisë, i cili e solli eksperiencën nga Shqipëria si dhe Znj. Nuran Zelen Gulersoy, ligjëruese në Universitetin Teknik të Stambollit e cila e solli eksperiencën turke për planifikimin pjesëmarrës duke dhënë shem-

buj konkretë nga tri qytete në Turqi. Eksperiencat e suksesshme nga komunat e MuSPP-it nga Juniku, Hani i Elezit dhe Mitrovica u prezentuan nga zyrtarët komunalë, Znj. FerdoneTofaj, Z. Durim Dernjani si dhe Znj. Shyhrete Peci.

Poashtu në këtë konferencë prezentuan edhe Znj. Suzana Goranci, Udhëheqëse e Sektorit për Planifikim Komunal pranë Departamentit të Planifikimit Hapësinor në MMPH, Z. Ilir Gjinolli, profesor në Departamentin e Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës, Z. Luan Shllaku, Drejtor i KFOS-it, si dhe Znj. Elvida Pallaska nga Instituti i Planifikimit Hapësinor.

Pjesëmarrësit në këtë takim kontribuan duke ngritur dhe diskutuar për çështje të shumta përmes shkëmbimit të eksperiencave dhe reflektimeve profesionale. Planerët theksuan se pjesëmarrja e vendim-marrësve në proceset e planifikimit theksohet të jetë një çështje mjaft e rëndësishme, ngase në shumë raste vendimet e marra nga politikanët nuk janë në përputhje me vizionin e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe akterëve tjerë. Gjatë dialogut të zhvilluar, ishte mëse e qarte se kuptimi dhe pjesëmarrja në procesin e planifikimit është relativisht i dobët, por kjo gjë edhe është pritur duke konsideruar se Kosova ndodhet në fazë tranzitore. Me notë pozitive, suksesi brenda komunave të Kosovës që është parë deri më tani përmes qasjes pjesëmarrëse sugjeron që përmirësimi do të vazhdojë dhe do të ngritet edhe më tej në të ardhmen.

Para konferencës, me 8 Nëntor, MuSPP-i dhe partnerët e tij e organizuan ligjeratën publike “Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe Rural” në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Ligjerata u hap nga Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ulëset në amfiteatrin e bibliotekës u mbushën me studentë dhe planerë si dhe me përfaqësues tjerë që mirren me çështje të planifikimit nga komunat e Kosovës.

Në ligjeratë prezentuan ekspertët ndërkombëtar të planifikimit, që u përcoll me diskutim aktiv nga pjesëmarrësit dhe pyetjet e shumta për ligjëruesit, që prezentuan nga tri kënde të ndryshme duke u bazuar në eksperiencat e tyre, nga tri vende të ndryshme.

**Rudina Qerimi**  
UN-HABITAT/MuSPP



# Editoriali



## Të dashur lexues,

Ky edicion i buletinit të MuSPP-it përmbanë informata në lidhje me aktivitetet e fundit të Programit në nivel qendror dhe lokal, për zhvillimet në komunat partnere, si dhe inicimin e nismave të rëndësishme në Kosovë dhe ka për qëllim promovimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në planifikimin hapësinor dhe urban.

Në këtë buletin është i përfshirë raport i një anëtari të stafit të MuSPP-it, Sami Stavoga, i cili morri pjesë në Shkollën Verore për profesionistët e rinj urban, organizuar nga zyra e UN-HABITAT-it në Varshavë dhe Shoqata e Shkollave Evropiane të Planifikimit (AESOP) në bashkëpunim me Shoqërinë Ndërkombëtare të Qytetit dhe Planerëve Rajonal (ISO-CARP) dhe Asociacionit Evropian për Hulumtime Urbane (EURA).

Vëmendje i është dhënë Ligjëratës për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban dhe Rural dhe Konferencës për Vizionim që mbledhi profesionistë të Kosovës gjatë dy ditëve të debatit. Ky aktivitet u organizua nga MuSPP-i në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Trashëgimia Kul-

turore pa kufi (CHWB) dhe Friedrich Ebert Stiftung (FES)

Pjesëmarrja e folësve të ftuar nga Suedia, Turqia dhe Shqipëria dhe një mundësi të mirë për shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare në këto fusha, ku materialet e Konferencës janë në përgatitje e sipër dhe do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të MuSPP-it.

Gjithashtu u njoftua për Memorandumin e Mirëkuptimit me Komunën e Mamushës, që i vë themelet e bashkëpunimit me këtë komunë në zhvillimin e Planit Zhvillimor Komunal. Në ndërkohë Memorandumet e Mirëkuptimit u nënshkruan edhe me Graçanicën dhe Parteshin, këto dy komuna të reja të krijuara me procesin e decentralizimit. MM me Graçanicën çoi në organizimin e një punëtorie të vizionimit, si një nga hapat e parë në procesin e planifikimit dhe gjatë konsolidimit e lejon angazhimin e shoqërisë civile. Punëtorja është mbështetur nga MMPH, CHWB dhe, FES. Pjesëmarrja e ekspertëve nga Zyra Civile Ndërkombëtare, të cilët merren me trajtimin e Zonave të Veçanta të Mbrojtjes ishte me rëndësi kyçe për këtë komunë e cila i ka disa zona nën mbrojtje.

Hapja për shqyrtim publik e Planeve Zhvillimore Komunale në Junik dhe Han të Elezit, e solli rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut gjatë gjithë procesit të planifikimit. Pjesëmarrja e një numri të madh të qytetarëve në këtë proces e tregon rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtën e tyre për të shprehur mendimet në lidhje me zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunave të tyre. Përpilimi i këtyre planeve është si bazë për zgjedhjen e projekteve kapitale. Në të njëjtën kohë, angazhimi i qytetarëve

ishte gjithashtu i rëndësishëm në këtë rast. Shembuj të pjesëmarrjes publike në projektet e investimeve kapitale në Han të Elezit dhe në Mitrovicë janë shembuj të mirë të planifikimit gjithë-përfshirës të projekteve kapitale.

Themelimin e Këshillit për Planifikim Hapësinor, si një organ këshillues dhe konsultativ dëshmon për rëndësinë që Qeveria e Kosovës i jep planifikimit hapësinor dhe urban për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës. Gjithashtu, themelimi i një shoqate profesionale të planifikuesve të Kosovës shënon një hap të ri në krijimin e një forumi për debat profesional për zhvillimin hapësinor.

Buletini në brendësi përmban më shumë informacion të detajuar mbi rolet dhe aspiratat e këtyre dy organizatave.

Buletini gjithashtu mbanë një artikull karakteristik nga stafi MuSPP-it mbi situatën në Han të Elezit. Po ashtu, në këtë edicion do të paraqiten edhe fragmente nga këndi i mediave të shkruara për aktivitetet e MuSPP-it.

Shpresojmë se ky buletin do të zgjojë interesim tek ju. Ne ftojmë qeverinë dhe zyrtarët komunal, profesionistët, si dhe qytetarët, burra dhe gra, djem dhe vajza të na shkruajnë për idetë e tyre për zhvillimin e qyteteve, qytezave dhe fshatrave në Kosovë.

Letrat më interesante të dërguara nga ju do të botohen në buletin tonë.

**Krystyna Galezia,**

KKT/ Shefe e UN-HABITAT Zyra në Kosovë



**PËR MË SHUMË:  
WWW.UNHABITAT-KOSOVO.ORG**

## SHKOLLA EVROPIANE VERORE URBANE



Një përfaqësues i MuSPP mori pjesë në Shkollën Evropiane Verore Urbane në Wrocław të Polonisë. Shkolla ishte organizuar nga UN HABITAT-i dhe Asociacioni i Shkollave Evropiane të Planifikimit (AESOP) në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Planerëve Regjional dhe të Qyteteve (ISOCARP) dhe Asociacionit Evropian për Kërkime Urbane (EURA). ShEVU (EUSS) u mbajt në objektin e Universitetit Teknologjik të Wrocław / Fakultetit të Arkitekturës nga 10 deri me 19 Shtator 2010.

Pjesëmarrësit në shkollë ishin me se shumti nga vendet Evropiane, por kishte edhe të atillë nga vende të tjera të Botes. Ligjëruesit vinin gjithashtu nga universitete dhe lëmi të ndryshme.

Tema e ShEVU ishte: A është "e vjetra" e qëndrueshme? A është "e kaluara" e qëndrueshme? A është trashëgimia e qëndrueshme? Ndikimi i njeriut modern në mjedisin natyror ashtu si edhe në konditat ekonomike dhe sociale është debatuar gjerësisht. Një pikëvështrim që në përgjithësi është pranuar është se ndikimi i njeriut i ka përkeqësuar gjerat në vend se ti përmirësoje. Në vend se të përkrahim atë se kohërat e vjetra ishin kohe të mira, ShEVU kishte për qëllim që të kërkojë një përgjigje joformale. U studiuan tre aspekte të zhvillimit urban: mjedisi, shoqëria dhe ekonomia. Dhe krejt kjo në suaza të krahasimit të "se vjetrës" me "të rene", në përpjekje që të njihen ndryshimet dhe ngjashmëritë thelbësore dhe duke u fokusuar në parashtrimin e pyetjeve të duhura të percjellura me përgjigje të arsyeshme.

I gjithë programi shkollor ishte i ndarë në tri pjesë. Programi filloi nga detalet duke përfshirë edhe trashëgiminë si një komponent shumë i rëndësishëm. Pastaj u kalua në një qasje me të përgjithshme të Qytetit të Wrocław duke diskutuar modelet dhe shtresat e entiteteve hapësinore, qeverisjes

dhe kontekstit kulturor. Dhe u përfundua me pjesën ku renditja dhe kontrolli hapësinor me lidhjet fizike dhe të tjera u analizua dhe u dhanë zgjidhje pragmatike. U punua me metodën e punës grupore. Secili grup zhvilloi dhe prezantoi nga tri detyra të cilat korrespondojnë me tri pjesët e programit. Detyrat ishin zgjedhur nga nikoqiri që me parë. Të gjitha ato kishin të bënin me qytetin e Wrocław. Grupet duhej të zgjidhnin një detyrë dhe pastaj përmes vizitave studimore, analizave të dokumenteve/hartave, debateve, ideve të ndryshme, etj; të prezantonin idetë e tyre themelore dhe koncepti i cili do të përdorej; dhe në fund përmes dizajnit të modeleve, skicave, diagrameve ose mënyrave tjera që do t'iu dukeshin me të përshtatshme të prezantojnë zgjidhjen e detyrës së dhënë. Zgjidhja e fundit mund të ishte në formë të një ideje të thjeshtë, diagrameve, propozimit të një strukture qeverisëse, një koncepti të ri të organizimit hapësinor, një program social i ri që do të aplikohet, të aprovohen disa rregullore të reja, etj.

Secila detyrë grupore u zhvillua paralelisht me ligjëratat të cilat ishin shumë të rëndësishme në formësimin e të gjithë procesit punues duke ofruar informata shumë të veshme nga përvojat e vendeve të ndryshme.

Detyrat e zhvilluara ishin shembuj shumë të veshëm të krijimit dhe identifikimit të formave të reja urbane dhe regjenerimit

urban/te qytetit. Regjenerimi urban në vetvete është një proces shumë kompleks që është dhe do të jetë sfida për vendin tonë. Format e reja urbane janë gjithashtu prezent në rritjen e qyteteve në Kosovë dhe përmes krijimit të qendrave të reja urbane si proces i decentralizimit.

Është shumë e rëndësishme që kjo eksperiencë dhe aspektet e zhvilluara të mund të prezantohen dhe të përdoren gjerësisht në mënyrën e hartimit "në shtëpi" të planeve zhvillimore komunale dhe urbane sikurse edhe hartimit të planeve rregulluese urbane.

Implementimi i këtyre planeve është gjithashtu një pjesë shumë e rëndësishme. Gjate këtij eventi detyrat e zhvilluara identifikuan disa përmirësime urgjente në mënyrë që lagjet apo distriktet e caktuara të mund të luanin rolin e tyre në kontekstin e përgjithshëm të qytetit dhe funksionimit të tij. Kjo gjithashtu është e lidhur ngushtë me identifikimin, zhvillimin dhe implementimin e projekteve kapitale.

Ligjëratat e dhëna ishin gjithashtu të rëndësishme sepse treguan rastet e kërkimeve të duhura në shumë fusha, regjenerime kompjuterike të popullatës, zhvillimeve të mundshme hapësinore bazuar në komponentë të ndryshëm, trafikut, etj; zhvillime tjera të shkelqyeshme dhe raste detale të regjenerimit urban. U dhanë shumë shembuj se si të trajtohet trashëgimia industriale. Për Kosovën në përgjithësi dhe Hanin e Elezit në veçanti kjo mund të ishte një përvojë shumë e mire.

Puna grupore me profesioniste të ndryshëm nga vende të ndryshme ishte gjithashtu një përvojë shumë e mire. Pikëpamjet dhe qasjet e ndryshme se bashku me zgjidhjet e ndryshme e përmirësuan përshtypjen e përgjithshme për ShEVU.

**Sami Stagova**  
UN-HABITAT/MuSPP



## TRUPAT E RINJ ORGANIZATIOV NË PLANIFIKIM

### KËSHILLI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR I KOSOVËS



Qeveria e Kosovës në mbledhjen e datës 13 maj 2010 kishte aprovuar vendimin për formimin e Këshillit për Planifikim Hapësinor (KPHK), dhe anëtarët e këtij këshilli në tërësi sipas Ligjit për planifikim hapësinor nr.2003/14, me ndryshimet e plotësuar në vitin 2008 (Nr. 03/L-106), si organ konsultativ të saj (neni 7, gjegjësisht 6). Me 17.06.2010 në mënyrë solemne në mjediset e MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) u prezantuan anëtarët e Këshillit të cilët në të ardhmen duhet të jenë një mbështetje madhe posaçërisht për MMPH në aspektin profesional. Me 27 tetor 2010 u zgjodhën organet udhëheqëse, me fjalë të tjera filloi puna e Këshillit të

cilin e presin punë të shumta në të ardhmen.

Ekspertët e emëruar në KPHK duhet të japin mendime, propozime vërejtje konstruktive dhe profesionale, me argumente të qëndrueshme, pa anime politike, rajonale apo grupe, dhe të përcjellin zbatimin e të gjitha dokumenteve hapësinore, si dhe rishikimin, harmonizimi dhe plotësimin e ligjeve dhe akteve nën ligjore që e përthekojnë fushën e Planifikimit Hapësinor në Kosovë. Obligimet që rrjedhin nga detyrimet e programi të Ministrisë (MMPH) dhe Qeverisë të Republikës së Kosovës në fushën e Planifikimit Hapësinor, të cilat i aprovon Kuvendi i Kosovës duke respektuar interesat e shtetit të Kosovës. Të gjitha këto janë detyrat kryesore të Këshillit, të rëndësishme për funksionimin e një shteti si është Kosova.

Ka shumë detyra tjera komplekse të Këshillit (KPHK) që duhet t'i kryejë më përgjegjësi të plotë, së pari profesionale e pastaj morale si: Përcjellja e zhvillimeve hapësinore në Kosovë në regjion dhe ma gjerë, propozimi i politikave hapësinore të sinkronizuara me

principet evropiane; Të propozojë dhe këshillojë për metodologjitë e punimit të planeve hapësinore dhe urbane në të dy nivelet;

Të propozojë masat për përmirësimin e gjendjes në hapësirë, posaçërisht në fushat e shfrytëzimit racional të hapësirës nëpër qytete tona, si është trashëgimia natyrore dhe kulturore, si dhe hapat e rëndësishme infrastrukturore si auto-rrugët, hekurudhat termo dhe hidro elekt→ranat etj.

Këshilli në bashkëpunim me MMPH duhet të propozojë dhe definojë kriteret për planet hapësinore, për caktimin e lokacioneve, cakton kriteret për të përcjellë, udhëzuar dhe vlerësuar kualitetin e punës së Planeve Hapësinore dhe dokumenteve tjera të rregullimit hapësinor. Kriteret për objekte me rëndësi të posaçme për shtetin si janë zonat e parqeve industriale, zonat për eksploatimin e pasurive natyrore mbitokësore dhe nëntokësore, si dhe veprimet e tjera në hapësirë.

**Ylber Vokshi - Ylli,**

*Kryetar i Këshillit për Planifikim Hapësinor të Kosovës (KPHK)*

### THEMELOHET ASOCIACIONI I PLANERËVE TË KOSOVËS

Me datë 27 Tetor 2010 në Villën Gërnia, me iniciativën e një grupi të profesionistëve në fushën e planifikimit urban dhe hapësinor u formua Asociacioni i Planerëve të Kosovës (AsPK). AsPK ka statutin e një organizate vullnetare, të vetqëndrueshme dhe jo pr ofitabile e cila mëton avancimin e shkencës dhe artit të planifikimit hapësinor-urban në të mirën e interesit publik-shoqëror. Qëllimet kryesore të AsPK janë promovimi i vlerave profesionale që i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës në rajonin e gjerë; kontribui mi në mbrojtjen e identitetit kulturor të hapësirës dhe vendbanimeve të saj duke eliminuar diferencat e qasjes në shfrytëzimin e të mirave natyrore, kulturore dhe materiale nga ana e qytetarëve; këmbimi me përvojat dhe informatat profesionale në fushën e urbanistikës dhe planifikimit hapësinor.

Përmes aktiviteteve të ndryshme AsPK synon të kontribuojë në afirmimin e planifikimit hapësinor dhe koncepteve bashkëkohore në shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e hapësirës për të krijuar një kulturë të re ndaj hapësirës; avancimin e planifikimit; ofrimin e mbështetjes së institucioneve në vendosjen e standardeve profesionale dhe etike në profesionin e planifikimit si dhe hartimin e politikave në këtë fushë, influencim në ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut, bashkëpunimin me organizatat e ndryshme etj.

AsPK përbëhet nga anëtarë të rregullt dhe anëtarë të nderit, kurse organet e saj janë: Kuvendi i përgjithshëm si organi më i lartë i Asociacionit i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët, Këshilli ekzekutiv si organ i cili menaxhon aktivitetet profesionale dhe ato administrative të organizatës; Këshilli mbikëqyrës i cili

monitoron punën e Këshillit ekzekutiv dhe Gjyqin e nderit i cili përcjell punën e Asociacionit dhe udhëheq procedura apo dhe masa diciplinore në raste kur ka shkelje serioze të cilat cenojnë interesat dhe reputacionin e shoqatës .

*vazhdon në faqe 5*



nga faqja 4

AsPK është ende në fazën e konsolidimit si organizatë. Në vitin e parë të punës, fokusi i angazhimit të AsPK do të jetë në afirmimin e AsPK në shoqëri në kosovare dhe më gjerë, vendosjen e kontakteve me institucione, organizata, universitete dhe asociacione vendore dhe ndërkombëtare si dhe sektorin privat në mënyrë që të kri-

jojë një rrjet të institucioneve të involvuara në planifikim hapësinor e urban. Një ndër aktivitetet e parapara në vitin e saj të parë të punës janë: Bienalja e Urbanizmit, organizimi i shkollës verore, mbajtja e këshillimit të parë të planerëve të Kosovës me temë aktuale në fushën e planifikimit, shënimi i ditës botërore të planifikimit, publikimi i buletinit dhe mbajtja e Kuvendit të

përgjithshëm të AsPK në Nëntor 2011.

Prishtinë/Pristina 03.12.2010

**Kadrush Grezda,**

*Kryetar i Asociacionit të Planerëve të Kosovës*

## KËNDI I MEDIAVE

### MIRATOHET PLANI RREGULLATIV PËR ZATRAT

**fragment nga një artikull i botuar në të përditshmen "Zëri"**

05 Janar 2011

Kuvendi i komunës ka aprovuar planin rregullues për lagjen Zatra. Plani në të cilin punohet tash tre vjet, është aprovuar javën e kaluar, duke hequr edhe një nga zonat joformale në qytetin e Pejës. Përveç Planit Rregullativ për Zatratin i cili është aprovuar, gjatë këtij viti do të përfundohen edhe "Kristali" dhe "7 Shtatori".

Drejtori komunal i urbanizmit Gazmend Muhaxheri, gjatë prezantimit të planit ka thënë se me këtë dokument krijohen mundësitë që të gjithë

ata që kanë ndërtuar në këtë zonë, të pajisen me leje ndërtimi, nëse ndërtimet e tyre janë në përputhje me planin rregullues.

Në Planin zhvillimor për Zatratin, ka pasur vërejtje vetëm nga grupi i këshilltarëve nga PDK. Kryesuesi i këtij grupi, Sali Lajçi ka thënë se duhej bërë matjet e hollësishme të terrenit dhe se zona duhej ndarë në disa nënzona të ndryshme sipas specifikave.

Peja është komuna e parë në Kosovë që ka hartuar edhe planin zhvillimor



urban, që në vitin 2007 me angazhimin e një firme holandeze DNV që kishte hartuar një plan për zhvillimin dhe shtrirjen e qytetit në periudhën njëzetvjeçare.

Kjo kishte kaluar përmes një procesi të gjatë me shumë pjesëmarrës financiar nga SIDA suedeze dhe me ndihmën e UN-HABITAT, Mobkos, Syri i Vizionit dhe organizata të tjera vendore.

### PJESËMARRJA NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

**fragment nga një artikull i botuar në të përditshmen "Express"**

17 Nëntor 2010

Më saktësisht, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe UN-HABITAT-i zyra në Kosovë, me 08 dhe 09 nëntor u mbajt ligjërata me temë "Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe Rural", dhe Konferenca interesante dhe e rëndësishme për shoqërinë tonë "Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës". Interesimi për të marrë pjesë në këto ndodhi jo të rëndomta për ne, ishte në nivel shumë të lartë, ku pos dy ministrave dhe profesionistëve të ftuar, kishte edhe shumë pjesëmarrës të tjerë, pasi karakteri i këtyre takimeve

ishte i hapur për të gjithë publikun.

U prezantuan, shpjeguan, eksperiencat të ndryshme në tërë botën në fushën e planifikimit hapësinor, urbanizmit dhe arkitekturës. U elaborua pjesëmarrja e banorëve në procesin e planifikimit urban, dhe shumë çështje tjera të ndërlidhura me jetën urbane. Përfaqësuesit eminentë të ftuar nga Suedia, Turqia dhe Shqipëria treguan eksperiencat e shteteve të tyre në pjesëmarrjen e banorëve në procesin e përpilimit të dokumenteve të planifikimit

hapësinor dhe urban. Edhe shembujt e tri komunave kosovare (Juniku, Hani i Elezit dhe Mitrovica) me përkrahjen e UN-HABITAT-it nga Programi për "Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal" (PMPHK), që u prezantua në konferencë ishin mbresëlënëse. Ishin inkurajuese se si këto komuna e kanë zhvilluar procesin e pjesëmarrjes së banorëve, edhe se situata reale as përfaqëson nuk korrespondon me realitetin e zhvillimeve urbane në ato mjedise. Vizionimi pjesëmarrës si mjet i planifikimit hapësinor padyshim ndihmon në organizimin e ardhshëm të territorit si dhe të menaxhimit të ndonjë lagjeje, qyteti apo regjioni. Bazuar në vizionin dhe konceptet e përbashkëta, domosdo duhet përkrahje ma e gjerë e shoqërisë për këto procese.

**Pjesëmarrja në procesin e Planifikimit Hapësinor**  
Ylber Vokshi - VIII  
Më saktësisht, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe UN-HABITAT-i zyra në Kosovë, me 08 dhe 09 nëntor u mbajt ligjërata me temë "Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe Rural", dhe Konferenca interesante dhe e rëndësishme për shoqërinë tonë "Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës". Interesimi për të marrë pjesë në këto ndodhi jo të rëndomta për ne, ishte në nivel shumë të lartë, ku pos dy ministrave dhe profesionistëve të ftuar, kishte edhe shumë pjesëmarrës të tjerë, pasi karakteri i këtyre takimeve ishte i hapur për të gjithë publikun. U prezantuan, shpjeguan, eksperiencat të ndryshme në tërë botën në fushën e planifikimit hapësinor, urbanizmit dhe arkitekturës. U elaborua pjesëmarrja e banorëve në procesin e planifikimit urban, dhe shumë çështje tjera të ndërlidhura me jetën urbane. Përfaqësuesit eminentë të ftuar nga Suedia, Turqia dhe Shqipëria treguan eksperiencat e shteteve të tyre në pjesëmarrjen e banorëve në procesin e përpilimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe urban. Edhe shembujt e tri komunave kosovare (Juniku, Hani i Elezit dhe Mitrovica) me përkrahjen e UN-HABITAT-it nga Programi për "Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal" (PMPHK), që u prezantua në konferencë ishin mbresëlënëse. Ishin inkurajuese se si këto komuna e kanë zhvilluar procesin e pjesëmarrjes së banorëve, edhe se situata reale as përfaqëson nuk korrespondon me realitetin e zhvillimeve urbane në ato mjedise. Vizionimi pjesëmarrës si mjet i planifikimit hapësinor padyshim ndihmon në organizimin e ardhshëm të territorit si dhe të menaxhimit të ndonjë lagjeje, qyteti apo regjioni. Bazuar në vizionin dhe konceptet e përbashkëta, domosdo duhet përkrahje ma e gjerë e shoqërisë për këto procese.

## KËNDI I UN-HABITAT-IT

### AGJENCITË E KOMBEVE TË BASHKUARA I BASHKOJNË FORCAT PËR TË VEPRUAR KUNDREJT NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Agjencitë e KB-së kanë diskutuar për angazhimin e tyre për të vepruar kundrejt ndryshimeve klimatike. Përfaqësuesit e UN-HABITAT-it, Konventa në kuadër të KB-së për ndryshime klimatike, Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara, Strategjia Ndërkombëtare e KB-së për Reduktimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore, Programi Botëror i Ushqimit si dhe Organizata Botërore e Meteorologjisë kanë përshkruar kapacitetin kolektiv të sistemit të OKB-së dhe aftësisë së saj për të mbështetur angazhimin e përbashkët për zbutjen e ndryshimeve klimatike në botë. Pjesëmarrësit në samitin e gjashtë për ndryshimet klimatike në Kankun, Meksiko u njoftuan se si efektet anësore të ndryshimeve klimatike do të vazhdojnë ta pengojnë zhvillimin e qën-

drueshëm, në qoftë se nuk ndërmerret aksion për planifikimin e duhur. Duke folur në Samit, Axumite Gebre-Egziabher, udhëheqës i Divizionit Global në UN-HABITAT-it, tha se me gjysmën e popullsisë botërore që sot jetojnë në qytete dhe me më shumë se një miliard nga ta në vendbanime joformale, vlerësimet e dobësive të qyteteve duhet të zgjidhen dhe të integrohen në politika të përmirësuar të planifikimit urban në qoftë se sfidat e krijimit të qyteteve të qëndrueshme kanë nevojë të plotësohen. Gebre-Egziabher poashtu theksoi se edhe pse angazhimi për adaptimin dhe uljen e pasojave të ndryshimeve klimatike është në nivel global, implementimi duhet të bëhet në nivel lokal. Duke komentuar pas takimit, Rafael

Tuts, udhëheqës i Njësisë për Mjedis Urban dhe Planifikim në UN-HABITAT, tha "Takimi i Kankunit e përsëriti rolin e sistemit Kombeve të Bashkuara në mbështetje të qyteteve, në veprimet e zbutjes së ndryshimeve klimatike". "Shembujt nga Meksiko, Filipinet, Jordani, Norvegjia dhe Spanja nënvizuan se si aksionet në qytete mund të përmirësohen nëpërmjet partneritetit ndërkombëtar" shtoi ai. Për shumicën, Kankuni i dha një shtytje adaptimit dhe zbutjes së procesit të ndryshimeve klimatike, me Marrëveshjen e Kankunit duke i vendosur më shumë vende në rrugën për uljen e emisionit në të ardhmen.

*burimi: [www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org)*

### Konferenca e Tretë Ndërkombëtare për Sigurinë e Grave: Krijimi i Qyteteve Përfshirëse

NEW DELHI, INDIA 22 - 24 NËNTOR 2010



Tema e Konferencës së Tretë Ndërkombëtare për Sigurinë e Grave është "Krijimi i qyteteve përfshirëse". Kjo temë e nënvizon se si koncepti i sigurisë së grave mund të përdoret si pikë hyrëse për të vepruar në VAË dhe në të drejtat e grave përmes përfshirjes strategjike të gjithë akterëve kyç urban dhe të vendimmarrësve, duke përfshirë ato femra që zëri dhe perspektiva e tyre nuk do të mund të dëgjoheshin ndryshe. Kjo konferencë do të mbështetet në sukseset paraprake duke i adresuar çështjet aktuale siç janë rritja e shpejtë e popullsisë urbane dhe efekti i saj në grupet e papërfshira shoqërore.

Nevojat e grave që jetojnë në vendbanimet joformale dhe në lagje jo të favorshme, të grave të moshuara, grave me aftësi të kufizuara, grave indigjene, atyre lesbike dhe transseksuale, dhe atyre nga minoritetet etnike dhe kulturore, vazhdojnë të paraqesin sfida të veçanta për ata që punojnë për të përfshirë grupet përfaqësuese të grave në qytete të sigurta, në të drejtat e grave dhe punën e VAË. Si rezultat, komuniteti ndërkombëtar duhet që tani të fokusohet në përfshirjen e grave përmes një spektri të gjerë, që ka të bëjë me rastet kur

gratë ballafaqohen me mospërfshirje në qytetet në mbarë botën.

Gratë, në çdo nivel të jetës urbane do të jenë në qendër të manifestimit, duke e shkëmbyer forcën dhe eksperiencën e tyre për qëllim të zhvillimit të strategjive në mënyrë kolektive që kanë të bëjnë me çështjet nga të cilat kërcënohet siguria dhe barazia e grave.

Konferenca e Tretë Ndërkombëtare për Sigurinë e Grave e ofron mundësinë e vërjes së bazës dhe zgjerimin e qasjes lokale dhe ndërkombëtare në ndërtimin e qyteteve të sigurta dhe më gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat.

Ky takim u mundëson pjesëmarrësve që në mënyrë kolektive ta shqyrtojnë se si këto metodologji janë ose do të mund të adaptohen, sa kanë qenë të suksesshme, dhe si do të mund të përmirësohen dhe të përdoren çdokund me qëllim të përbaljes me çështje të reja dhe emergjente.

Përveç kësaj, konferenca do të jetë një hapësirë për mësim dhe për ngritjen e kapaciteteve të grupeve lokale, në mënyrë që aktorët e ri të mund ta marrin përgjegjësinë për implementimin e qasjes për qytete të sigurta dhe gjithëpërfshirëse në komunitetin e tyre. Në mënyrë

më specifike, objektivat e Konferencës së Tretë Ndërkombëtare për Sigurinë e Grave janë:

Të shqyrtojë, analizojë dhe konsolidojë qasjet/mjetet e ndryshme që kanë si qëllim ndërtimin e qyteteve të sigurta dhe përfshirëse, të ndërtojë kapacitete të fuqishme brenda nivelit lokal të shoqërisë civile me qëllim të mobilizimit të mbështetjes së gjerë të komunitetit për qytete të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, të vlerësojë dhe të përhapë mësimet e mësuara dhe praktikatat më të mira të zhvilluara për rritjen e përfshirjes dhe të drejtën e grave në qytete.

Konferenca e Tretë Ndërkombëtare për Sigurinë e Grave u organizua në bashkëpunim me një numër partnerësh kyçë ndërkombëtarë për ti bërë qytetet sa më të sigurta për gratë të punojnë. Partnerët që bashkëpunuan në organizimin e kësaj konference janë Red Mjedis y Habitat de America Latina dhe Komisioni nga Huairou në bashkëpunim me United Nations Development Fund for Women (UNIFEM) si dhe me United Nations Human Settlements Programme (UN-HABITAT).

*burimi: [www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org)*

## KËNDI I KOMUNAVE

### Komuna e Junikut hapë diskutimin publik për draftin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2010 – 2023 +

Ceremonia e hapjes së diskutimit publik për draftin e Planit Zhvillimor Komunal të Junikut filloi të premten, me 15 tetor në restorant "Oda e Junikut" në Junik. Kjo ngjarje i mbledhi më shumë se 150 pjesëmarrës, të interesuar për ta parë prezantimin e draftit të PZHK-së. PZHK-ja është hartuar nga stafi komunal i Junikut nga Drejtoria Komonale për Urbanizëm, Gjeodezi dhe Mjedis, dhe është mbështetur nga Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH) brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Diskutimi publik i PZHK-së do të jetë i hapur deri me 15 Dhjetor 2010. Diskutimi publik ua mundëson banorëve dhe akterëve tjerë që t'i japin pikëpamjet e tyre, komentet, dhe të ngrisin çështje dhe ta ofrojnë mendimin e tyre para se



plani t'i dorëzohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për shqyrtim, dhe më pas të miratohet në mënyrë përfundimtare nga ana e Asamblesë Komonale të Junikut. Në fjalën e tij hyrëse kryetari i Junikut Agron Kuçi, e përmendi rëndësinë e PZHK-së që është dokumenti i parë dhe më i rëndësishëm i hartuar nga stafi komunal. Procesi i hartimit të draftit të planit i lejoi stafit komunal që t'i ngrit kapacitetet e tyre për aktivitetet e ardhshme të planifikimit. Z.Kuçi poashtu e falënderoi MuSPP-in, CHwB-në dhe IPH-në së bashku me institutet dhe agjencitë tjera të cilat asistuan dhe e mbështetën procesin. Ai nuk e la pa e përmendur edhe punën e nisur me 2009, nga qeveria e mëparshme lokale. Në fjalën e saj hyrëse, udhëheqësja e UN-HABITAT-it në Kosovë, znj. Krystyna Galezia, i theksoi segmentet më të rëndësishme të Programit të MuSPP-it, që ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve, dhe në këtë rast, pa mëdyshje PZHK-në e Junikut e paraqiti si përvojë të suksesshme. Takimi u nderua me prezencën e këshilltarit të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Husnija Beshkovic, përfaqësuesve të institucioneve dhe agjencive të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare, komunave kosovare, Policisë së Kosovës, Agjensionit Regjional për Zhvillim RDA dhe EULOG-ut, të dyja këto të financuara nga ECLO, Programit Botëror të Ushqimit FAO, OSBE-së dhe KFOR-it. Duke e përdorur këtë rast Agjensionit



draft-  
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN  
OF JUNIK  
2010 - 2023 +

gjerman – GTZ e shprehu përkushtimin dhe gatishmërinë për implementimin e projekteve në sektorin e rinisë. Kjo iniciativë korrespondon me projektin në vazhdim e sipër për rregullimin e oborrit të shkollës, që bashkë-financohet nga ana e Komunës së Junikut dhe MuSPP-it. Komuna e Junikut është komuna e parë në Kosovë që e ka marrë një qasje tjetër për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK). Për dallim me praktikën e deritanishme për tenderimin e planeve komunale tek kompanitë lokale dhe ndërkombëtare të cilat kërkonin çmim të lartë, komuna e Junikut këtë plan e ka hartuar me resurset e veta. PZHK-ja e Junikut është gjithëpërfshirëse, dokument multi-sektorial që ka për qëllim të ofrojë vizion dhe qëllime të qarta për zhvillim e ardhshëm hapësinor të territorit të saj.

**Rudina Qerimi**  
UN-HABITAT/MuSPP

## NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME MAMUSHËN DHE ME KOMUNAT E REJA

Me 28 tetor 2010, udhëheqësja e Zyres së UN-HABITAT-it në Kosovë, znj. Krystyna Galezia dhe kryetari i Mamushës, Arif Butuc e nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal për Mamushën. Komuna e Mamushës në kohën kur e filloi planifikimin ishte pilot njësi komunale. Procesi i planifikimit filloi në Qershor 2008 me punëtorinë e vizionimit, organizuar nga UN-HABITAT-i në bashkëpunim me atëherë/Pilot Njësinë Komunale të Mamushës dhe Trashëgiminë Kulturore pa Kufi (CHwB). Përmes kësaj qasjeje të planifikimit, e pregatitur nga ekipa e MuSPP-it, u formulua vizioni i plotë


dhe gjithëpërfshirës për Mamushën. Në fund të vitit 2008, Pilot Njësia Komonale e Mamushës e fitoi statusin e plotë të komunës. Megjithkëtë me autoritetin e krijuar së fundi dhe në mungesë të dokumenteve relevante të planifikimit, kjo çoi në zhvillimin e pakontrolluar urban dhe hapësinor të Mamushës. Me qëllim të drejtimit dhe kontrollimit të zhvillimit në të ardhmen, Mamushës i nevojitej Plani Zhvillimor Komunal, që është kërkesë ligjore që del nga Ligji për Planifikim Hapësinor i Kosovës. Për ta arritur këtë, Komuna e Mamushës kërkoi mbështetje teknike nga UN-HABITAT-i për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal në kuadër të plani-

fikimit pjesëmarrës të Programit të Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP). Në të njëjtën kohë memorandumet e mirëkuptimit u nënshkruan me Graçanicën dhe Parteshin, dy këto komuna të reja të krijuara nga procesi i decentralizimit.

**Dafina Karahoda**  
UN-HABITAT/MuSPP

## KËNDI I KOMUNAVE

### HANI I ELEZIT INICON PROJEKTIN PËR INVESTIME KAPITALE DHE HAPË SHQYRTIMIN PUBLIK PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL 2010-2025



Në fund të vitit 2008 Komuna e Hanit të Elezit dhe PMKPH 2 i UN HABITAT-it (Programi i Mbështetjes së Komunave në Planifikim Hapësinor 2) nënshkruan Marrëveshjen e Mirëkuptimit për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal PZHK dhe Planin Zhvillimor Urban (PZHU).

Gjatë procesit të hartimit të PZHK-së u nënvizua mungesa e hapësirave publike brenda zonës urbane të Hanit të Elezit dhe në të njëjtën kohë, pasi që është komunë e re, kjo zonë është në proces të kalimit nga një zonë rurale në zonë urbane. Gjatë këtij procesi gjithashtu u theksua se qyteti është një nga më kryesorët në Kosovë që konsiderohen si pika të nxehta në aspektin e degradimit të mjedisit (më së shumti ndotje e ajrit dhe e tokës).

Si rezultat i atyre që u përmendën më lartë dhe diskutimeve të mëvonshme në mes të UN HABITAT-it dhe Komunës së Hanit të Elezit u dakordua se Projekti i Investimeve Kapitale do të kishte të bënte me rregullimin e hapësirave publike dhe do të bashkë financohej nga të dy palët.

Në procedimet e mëvonshme u hartua projekti zbatues që u fokusua në rregullimin e qendrës së qytetit.

Me 30 Shtator, 2010, zyra lokale në bashkëpunim me administratën qendrore të MuSPP-it (UN HABITAT-i) dhe Komunën e Hanit të Elezit organizuan ceremoninë e shkëmbimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës dhe UN HABITAT-it.

Në këtë takim morën pjesë stafi dhe Udhëheqësja e UN-HABITAT-it në Kosovë, Krystyna Galezia.

Projekti për përmirësimin e hapësirave publike në Hanin e Elezit është në implementim e sipër, derisa me 17 dhjetor 2010 u bë hapja e shqyrtimit publik të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2010-2025 e Hanit të Elezit dhe do të jetë hapur për publikun për 60 ditë, deri në 17 shkurt 2011.

Gjatë procesit të hartimit të PZHK-së, kanë qenë të përfshirë të gjithë sektorët e komunës duke shfrytëzuar kapacitetet e stafit komunal. Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedisit është aktori kryesor i projektit me mbështetjen e Programit për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor (MuSPP), i cili financohet nga SIDA dhe implementohet nga UN-HABITAT. Procesi i planifikimit ka qenë një mundësi e madhe në drejtim të sigurimit të pjesëmarrjes publike shumë aktive nga të gjitha grupet pjesëmarrëse të qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit.

Perioda e shqyrtimit publik është një nga hapat kryesorë që u mundësojnë të gjitha palëve të interesuara që të japin opinionet e tyre për finalizimin e PZHK dhe Hanit të Elezit, dhe kjo do të jetë mundësia e fundit për qytetarët e komunës për të dhënë mendimet përfundimtare dhe të diskutojnë çështje të ndryshme më rëndësi në lidhje me planin.

Gjatë ceremonisë së hapjes së shqyrtimit publik ishin të pranishëm përfaqësues shumë të rëndësishëm të institucioneve dhe organizatave të ndryshme sikurse: zot Agim Radoniqi, Drejtor i Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Z. Luan Nushi, Drejtor i Institutit të Planifikimit Hapësinor, përfaqësues të Shërbimit Policor të Kosovës, KFOR-it, OSBE-ja, përfaqësues nga komunat fqinje, OJQ-të të ndryshme, media lokale dhe më e rëndësishmja e qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit. Në fjalën hyrëse, Z. Muzafer Dernjani, nënkryetari i komunës, vlerësoi rëndësinë e PZHK-së dhe angazhimin e stafit komunal dhe shprehu mirënjohjen e tij ndaj HABITAT-e OKB-së dhe SIDA për mbështetjen. Pastaj, Z. Ishaku Maitumbi, MuSPP, UN-HABITAT, theksoi rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve në komunë dhe përfshirjen aktive publike gjatë procesit të planifikimit. Z. Maitumbi gjithashtu theksoi se rasti i hartimit të planit në shtëpi (nga vete stafi komunal) në Han të Elezit është rezultat i pjesëmarrjes aktive dhe përpjekje të komunës. Z. Radoniqi dhe Z. Nushi theksoi rëndësinë e planifikimit për kontrollin e zhvillimit hapësinor dhe rritjen ekonomike. Pas fjalimeve hyrëse, z. Nexhmedin Daci, Drejtori i Urbanizmit dhe Kadastrit Mjedisit paraqiti draftin e PZHK.

Gjatë takimit kishte komente të ndryshme, si p.sh. për prioritetet e veprimeve/projekteve për zbatimin e planit, duke marrë parasysh kapacitetet financiare të komunës dhe gjithashtu për rëndësinë e zhvillimit të bujqësisë dhe turizmit kulturor etj.

**Sami Stagova & Pren Domgjoni**  
UN-HABITAT / MuSPP



## KËNDI I KOMUNAVE

### VIZIONIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË TË ARDHMEN E GRAÇANICËS

Programi i Planifikimit Hapësinor Komunal në bashkëpunim me Trashëgiminë Kulturore pa Kufi, Fondacionin Friedrich Ebert dhe me ICO-në, e organizuan punëtorinë e vizionimit në Ohër të Maqedonisë, prej 25 deri me 29 nëntor 2010. Punëtorja është element i mbështetjes së programit të UN-HABITAT-it për komunat kosovare në fuqizimin e kapaciteteve të tyre për qeverisje më efektive urbane, zhvillim të planifikimit hapësinor gjithëpërfshirës si dhe për fuqizim të shoqërisë civile për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes.

Zyrtarët komunalë duke përfshirë kryetarin, pjesëtarët e komunitetit dhe përfaqësues nga OJQ-të të ndryshme që operojnë në Graçanicë, duke përfshirë edhe përfaqësues të ndryshëm nga sektori privat punuan së bashku për ta zhvilluar vizionin e të ardhmes të komunës së tyre.

Qëllimi i kësaj punëtorie është të inkurajojë pjesëmarrësit që t'i shkëmbejnë mendimet dhe kujtimet e tyre për komunën dhe së bashku të fillojnë të mendojnë për të ardhmen, dhe të gjejnë mënyra se si ta bëjnë Graçanicën një vend të mirë për të gjithë.

Punëtorja filloi me vizuelizimin e hartës



së kujtimeve. Shumë zona publike, rrugë, lagje, resurse natyrore, zona të gjelbëra dhe në veçanti manastiri u përmendën dhe më pas u vizatuan në hartë. Pjesëmarrësit u familiarizuan me principet e planifikimit bazik dhe me mjetet e nevojshme me qëllim të kalimit në ide dhe synime më të gjera në prioritetet strategjike për zhvillimin e ardhshëm të komunës së tyre.

Ata u ndanë në katër grupe punuese, në temat në vijim: Trashëgimia Kulturore

dhe Natyrore, Infrastruktura dhe Mobiliteti, Zhvillimi Ekonomik si dhe Shërbimet Sociale dhe Banimi.

Secili grup e kreu analizën e SWOT-it për temën e caktuar. Detyrë e çdo grupi ishte identifikimi dhe analizimi më i gjerë i përparësisë, të metave, mundësive dhe kërcënimeve për situatën aktuale. Për më tepër, secili grup i zhvilloi objektivat dhe në fund këto gjetje u transformuan në "harta të vizionit". Në fund, pjesëmarrësit u pajtuan për moton dhe logon e përbashkët si dhe për deklaratën e vizionit.

Ky ishte hapi i parë drejt hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe rezultatet nga kjo punëtori do të përdoren si kontribut për fazat e ardhshme. Rezultatet nga kjo punëtori do të prezantohen para një audience të gjerë dhe qytetarëve të Graçanicës në një prezantim multimedial që do të mbahet në një të ardhme të afërt. Kjo do të ofrojë mundësi për diskutim derisa vërejtjet dhe sugjerimet shitesë do të merren parasysh.

**Gloriosa Hisari dhe  
Ximi Osmani**  
UN-HABITAT/MuSPP



## KËNDI I KOMUNAVE

### NXËNËSIT E SHKOLLËS METO BAJRAKTARI , MË TË SIGURT GJATË QASJES PËR NË SHKOLLË

Ceremonia e hapjes së projektit investues kapital "Përmirësimi i Qasjes në Shkollën Fillore METO BAJRAKTARI" në Mitrovicë, u organizua në oborrin e shkollës me 3 Nëntor 2010.

Projekti që u inicua nga peticioni i komunitetit të shkollës, u hartua në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet komunitetit të shkollës dhe të lagjes, departamenteve komunale si dhe nga Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal i UN-HABITAT-it në Mitrovicë.

Znj. Krystyna Galezia, Udhëheqëse e zyrës së UN-HABITAT/MuSPP-it në Kosovë e shprehu kënaqësinë për implementimin e këtij projekti i cili ofron qasje më të sigurt dhe më të lehtë për më se 1000 nxënës të kësaj shkolle dhe në të njëjtën kohë e përmirëson infrastrukturën e lagjes. Në fjalën e saj, ajo theksoi se UN-HABITAT-i, në mbështetje nga Sida, do të vazhdojë të marrë pjesë në investimet që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës së hapësirave

publike, që ofrojnë jetë më të mira në zonat urbane për të gjithë njerëzit, në veçanti për ata më të rrezikuarit.

Kryetari i Mitrovicës, Z Avni Kastrati, e shprehu mirënjohjen e tij për angazhimin e UN-HABITAT-it në Mitrovicë deri tash.

"UN-HABITAT-in e kemi partner strategjik dhe shpresojmë se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në projekte tjera të rëndësishme në qytet." tha ai.

Pjesë e këtij projekti ishte mbyllja e qasjes në oborrin e shkollës për veturat, mbylljen e gropave me beton, përmirësimi i sipërfaqes alternative për ecje, ngritjen e sipërfaqes së rrugës gjatë qasjes më udhëkryq, vendosjen e masave për uljen e shpejtësisë dhe ndalesa e parkimit, vendosja e shenjave për lokalet e Handikosit, si dhe vendosja e ndriçimit në të dy anët.

Përmirësimi i qasjes në Shkollën Fillore "Meto Bajraktari" në Mitrovicë, është financuar 50/50 nga Komuna e Mitrovicës dhe Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal, Faza 2 (MuSPP2) e UN-HABITAT-it në Kosovë, financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Kooperim Ndërkombëtar, Sida.



**Drita Nushi**

UN-HABITAT/MuSPP

## TREGIMET KARAKTERISTIKE

### Qyteza me qiell gri

Në turneun tonë piktoresk në kufi me Maqedoninë, ne anën e djathtë me male dhe në anën e majtë me lumin Lepenc, shtrihet Komuna e Hanit te Elezit. Nga shumë karakteristika që i ka ky vend dy janë kryesore. E para: qytetarët e Hanit të Elezit janë të sëmurë potencial nga organet e frymëmarrjes, dhe së dyti të gjithë ata jetojnë nëpër shtëpi ku ngjyra e kulmeve shndërrohet në gri.

"Shikoni, shtëpia e vetme që e ka kulmin e kuq, është ajo atje e ndërtuar këtë vit" e fillon tregimin e tij Gani Shkreta. Për të, një kulmi i nevojitet vetëm një vit

që ta ndryshojë ngjyrën.

"Kam dëgjuar se qendra e qytetës do të rregullohet, dhe do të mbillen edhe disa pemë. Para disa dite një mik më tha se do të rrënohet edhe blloqet e vjetra të banimit që ndodhen para komunës" tha ai, duke shtuar se këto blloqe ishin të vetmet ndërtime të mbetura nga koha e Titos.

"Ai(Tito) ishte njeri i mençur" tha ai, duke e kthyer kokën në anën e kundërt. "Kam dëgjuar se edhe Zyrat e Administratës së Fabrikës së Çimentos, që sot përdoren nga administrata komunale,

po ashtu do të rregullohen" tregon 67 vjeçari Gani Shkreta.

Komuna me një popullsi prej 10 mijë banorëve, është krijuar nga procesi i decentralizimit në Kosovë me 2005, si pilot njësi. Me 2008, Hani i Elezit, u shndërrua në Komunë.

Ditët e para ishin të vështira për këtë komunë, ku ajo u përballë me shumë vështirësi, ku si sfidë kryesore ishte mungesa e rregullimit urban dhe parandalimi i ndërtimeve pa leje.

*vazhdon në faqe 11*

*nga faqja 10*

Të pa përvojë në këtë aspekt dhe në mungesë të mjeteve financiare, Komuna e Hanit të Elezit më shumë e kurrë kishte nevojë për investime dhe ngritje të kapaciteteve të stafit komunal.

Duke e parë këtë gjendje, UN-HABITAT-i përmes Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP) e përfshiu këtë komunë në programin e saj dhe menjëherë filloi me projektet/aksionet që do të ndërmerren. Bashkëpunimi në mes të Hanit të Elezit dhe UN-HABITAT-it filloi me Punëtorinë e Vizionimit të mbajtur në Ohër, ku pjesëmarrësit i shkëmbyen kujtimet e tyre dhe së bashku filluan të mendojnë për të ardhmen e qytetit.

Vizionimi si faza e parë për hartimin e planeve zhvillimore komunale, u pasua me disa takime dhe punëtori ku morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, organizatave afariste dhe qytetarë të shumtë. Dhe ja ky ishte fillimi me metodën "të mësojmë duke punuar" dhe metoda e "bërjes vet" të hartimit të dokumenteve të planifikimit, të mbështetura nga MuSPP-i.

Në të njëjtën kohë me këtë proces, nga Komuna u pa nevoja e rregullimit të qendrës së qytetit, projekt ky që filloi të implementohet me financim të barabartë nga Komuna dhe UN-HABITAT-i. Kostoja totale e projektit vlerësohet të jetë rreth 70 mijë euro.

### Sharrcem në ndryshim të reputacionit të tij

Shumica e njerëzve që sot punojnë në

Komunë pajtohen me atë se Komuna e tyre është krijuar bashkë me Fabrikën e Çimentos, edhe pse kjo fabrikë njihet si pikë e zezë për këtë komunë.

Për të hyrë në këtë "pikë të zezë" nevojitet leje e veçantë nga drejtori i kësaj ndërmarrjeje. Për sigurinë tonë, ne duheshim të vendosnim helmetë në kokë.

"Çdonjëri duhet ta vendos këtë në kokë, e as femrat nuk janë të përjashtuara" tregonte personi nga sigurimi në hyrje.

Para nesh ndodhet një botë e tërë nga metali dhe punëtorët që mundohen ta mbajnë këtë fabrikë në funksion. Në hyrje, korridori i ndërtesës ishte i zbukuruar me lule, edhe pse në tërë atë pjesë vinte era tym cigareje. U ngjitëm shkallëve për në derën e parë në katin e dytë. Kur e morën vesh se isha i interesuar për ndotjen dhe për mënyrën e filtrimit të gazrave, të gjithë mbetën të heshtur, duke thënë se nuk janë kompetentë të flasim për këtë çështje. Me gisht e treguan vendin ku mund të gjenim njerëz kompetent, në ndërtesën e administratës.

"Pyetni ata" thanë.

Shkallët e metalta, të frikshme dhe plot pluhur, qojnë në katin e parë të ndërtesës.

"A e dëshiron një filxhan kafe" më pyeti njëri nga ata.

"Faleminderit, nuk kam shumë kohë" ia ktheva.

Edhe pse ora ishte 1 pas dite, tymi vazhdonte të dilte nga oxhaku i "Sharrcemit", duke dhënë përshtypje se i mbyste retë, pas shiut.

"Shumica e njerëzve që punojnë këtu jetojnë në Hanin e Elezit. E ardhmja jonë varet nga puna që e bëjmë në "Sharrcem" tregon Ahmet Dernjani, njëri nga ta.

Ai e ndez një cigare. "Unë pi cigare dyfish. Pi tym edhe nga tymi që del nga oxhaqet, dhe nga cigarja e ndezur. Kjo që e kam në dorë është Marlboro, derisa nga oxhaku mund të jetë çdo gjë" tha ai. Por ata janë të vetëdijshëm se koha kur do të përmirësohet infrastruktura dhe zonat e gjelbra do të vjen shumë shpejt. Komuna do të mbjell drunj të ri, do t'i largojë rrethojat nga objektet e tyre dhe të tërë kjo zonë do të shndërrohet në një zonë të madhe të gjelbër. Kjo është ajo çka kishin dëgjuar për përmirësimin e qytetit të tyre.

"Ne kemi nevojë për gjelbërim, ashtu si peshku për ujë" tregoi Dernjani, duke shpresuar se Projekti Investues Kapital i UN-HABITAT-it nuk do të mbetet i pa menaxhuar ashtu si parku në oborrin e Sharrcemit. Ai e falënderon UN-HABITAT-in për mbështetje, edhe pse sipas tij "me një lule nuk qel pranvera".

"E tëra çka duhet banorët të bëjnë është që të kenë më shumë kurajë dhe motivim për t'i ndryshuar gjërat... dhe në të njëjtën kohë ta largojnë nga përdorimi shprehjen "Nuk është problemi im" shtoi Dernjani.

Ne lamë Sharrcemin duke punuar, duke shpresuar se një ditë fabrika dhe qyteza do të jenë modele të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë.

**Astron Mahmutaj**  
UN-HABITAT/MuSPP



## Edicioni i ardhshëm

- **PREZANTIMI PUBLIK I PUNËTORISË SË VIZIONIMIT PËR GRAÇANICËN**
- **SITUATA E TANISHME E PROJEKTEVE PËR INVESTIME KAPITALE TË KOMUNAVE TË MUSPP**
- **PËRFUNDIMI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR PËR HANIN E ELEZIT**

## BASHKË BËJMË QYTETE MË TË MIRA

MuSPP 2 është faza e dytë dhe më e avancuar e Programit të mbështetjes së planifikimit hapësinor komunal. Koncepti i tij është zhvilluar me komunat partnere në mënyrë që të sigurojmë konsolidimin e aktiviteteve të planifikimit të kryera në MuSPP1. Dizajni i programit është konsultuar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Sida-n. Programi adreson nevojën që të forcojmë kapacitetet e autoriteteve lokale dhe zyrtarëve të tyre profesional për implementimin e planeve zhvillimore të zhvilluara gjatë MuSPP1. Gjithashtu lidhet edhe me ekspertizën dhe përvojën ekzistuese në njësitë lokale dhe qendrore, të cilat janë përgjegjëse për aktivitete të planifikimit (p.sh. departamente komunale të urbanizmit, departamenti e planifikimit hapësinor dhe instituti i planifikimit hapësinor në MMPH). Bashkëpunimi në nivel qendror është i fokusuar në adresimin e qështjeve të cilat nuk janë në spektrin e përgjegjësisë të kompetencave komunale dhe ku mbështetja e nivelit qendror është themelore. MuSPP2 kërkon kyçje më direkte të organizatave të shoqërisë civile në implementimin e programit përmes sistemit të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Bazuar në mësimet e mësuara nga përvoja e kaluar, ofrimi i këshillave teknike dhe mbështetja këtë herë është bërë përmes qasjes së bazuar në projekte dhe me orientim kah rezultati.

## IMPRESSUM

**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE



*Bashkë bëjmë qytete më të mira*

**Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP)**

Kryekëshilltare teknike/  
Shefe e zyrës

**Krystyna Galezia**

krystyna.galezia@unhabitat-kosovo.org

**Zyra:**

Zyra e UN-HABITAT-it, Kosovë  
Ndërtesa e Ministrive "Rilindja"  
kati i 10-të,

Tel.: +381/38/20032611

Fax: +381/38/224122

më shumë për UN-HABITAT Kosovë:  
[www.unhabitat-kosovo.org](http://www.unhabitat-kosovo.org)

më shumë për: UN-HABITAT  
[www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org)

Editimi: Krystyna Galezia, Rudina Qerimi Editimi në gjuhën angleze: Jillian Bywater Përkthimi: Astron Mahmutaj  
shënim: artikujt origjinal në këtë buletin janë shkruar në gjuhën angleze

Ky Buletin është mundësuar nga Qeveria e Suedisë përmes Sida-s. Gjitha vështrimet, mendimet dhe konkludimet u përkasin autorëve. Kontributet në lidhje me komunat jo domosdoshmërisht reflektojnë pozitën e vendimet e komunave në fjalë. Përmbajtja e këtyre artikujve jo domosdoshmërisht reflektojnë: Qëndrimin e UN-HABITAT-it ndaj çështjeve të ngritura apo deklaratave të bëra, si dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë vështrimet e Sida-s.